



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 24 tetor 2022  
Nr. Ref.:RK 2059/22

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI225/21**

Parashtrues

**N.T. Spahia Petrol**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë  
së Aktgjykimit ARJ.UZVP. nr. 16/2021 të 8 shkurtit 2021  
të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania N.T. Spahia Petrol, të cilin e përfaqëson Florin Lata, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin ARJ.UZVP. nr. 16/2021, të 8 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e pranoi më 22 tetor 2021.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 14 dhjetor 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën e kishte dorëzuar në postë më 9 dhjetor 2021.
7. Më 16 dhjetor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi informata nga Gjykata Themelore në Prishtinë, lidhur me datën e pranimin të Aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
8. Më 17 dhjetor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë ia dorëzoi Gjykatës dosjen e lëndës nga e cila kuptohet se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 22 tetor 2021.
9. Më 15 janar 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
10. Më 20 shtator 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës parashtron për herë të dytë kërkesë në Gjykatë për të njëjtën çështje. Më parë kishte parashtruar kërkesën KI227/19, për të cilën Gjykata më 10 dhjetor 2020 nxori Aktgjykimin, me të cilin e shpalli të pavlefshëm

Aktgjykimin [ARJ. UZVP. nr. 94/2019] të 1 gushtit 2019 të Gjykatës Supreme, nga shkaku se i njëjti nuk ishte në përputhshmëri me garancitë procedurale të së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, sepse nuk përmbushte standardin e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, si rezultat i mosadresimit dhe arsyetimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës përkitazi me barazinë e armëve dhe mjetet efektive juridike.

**i. Përmbledhje e fakteve të kërkesës KI227/19**

12. Parashtruesi i kërkesës është i regjistruar si biznes individual, i cili nga viti 2000 ushtron veprimtarinë primare të tregtimit me karburante dhe veprimtari sekondare të restorantit. Policia e Kosovës, më 10 dhjetor 2014, pas kontrollove lidhur me hetime penale, kishte sekuestruar një numër të dokumenteve financiare tek parashtruesi i kërkesës. Në ndërkohë, Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: ATK) kishte zhvilluar kontroll tatimor në biznesin e parashtruesit të kërkesës, ku kishte evidentuar një numër parregullsish të cilat i kishte reflektuar në Raportin e Kontrollit të 26 tetorit 2015. Bazuar në pikën 7 të këtij raporti: (i) një kopje e tij i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës; ndërsa (ii) detyrimi i sigurimit të provave për të kontestuar të njëjtin, ishte në anën e tatimpaguesit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës.
13. Më 17 nëntor 2015, ATK i kishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës Vendimin mbi Njoftimin për Rivlerësimet e pagesës së tatimit shtesë në: (i) Tatimin në të Ardhurat Personale për periudhat 2011, 2012, 2013; dhe (ii) Tatimin e Vlerës së Shtuar për periudhat 06/2012 dhe 03/2013 (në tekstin e mëtejme: Njoftimi për Rivlerësimet). Më 26 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, kishte paraqitur *“kërkesë për lejimin e kthimit të përkohshëm të dokumenteve apo kopjeve të të njëjtave”*, duke theksuar se: (i) *“pas kontrollimeve nga Policia e Kosovës, na janë marrë përkohësisht edhe dokumentet financiare”*; (ii) në ndërkohë, nga inspektorët e ATK-së, *“për mungesë të dokumentacionit financiar i cili është marrë gjatë kontrollit, subjekti është ngarkuar me detyrime tatimore edhe pse subjekti posedon fletëdërgesa dhe faktuara por të cilat janë të ndaluara nga Policia dhe Prokuroria”*; dhe (iii) *“ndaj njoftimit të Inspektorëve të Administratës Tatimore kemi të drejtë ankimi deri me 09.12.2015, [dhe] për parashtrim të ankesës ne duhet të bazohemi në prova, andaj ju drejtohem me kërkesë që të na lejoni kopjet e dokumenteve financiare kopjet apo eventualisht dokumentet origjinale, për qëllime ankimi”*. Kjo kërkesë për njoftim, i ishte adresuar edhe Policisë së Kosovës dhe ATK-së. Sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës dhe shkresave të lëndës, ai asnjëherë nuk ka marrë asnjë përgjigje përkitazi me kërkesën e tij.
14. Më 16 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Njoftimit për Rivlerësimet në Departamentin e Ankesave të ATK-së duke kontestuar, mes tjerash, konstatimet e ATK-së lidhur me: (i) mënyrën e vlerësimit të qarkullimit shtesë në shumën prej 178,368.43 euro, duke mos i marrë parasysh fletëdërgesat e furnizimeve të mallit; (ii) mospranimin e shpenzimeve operative për periudhën 2011/2012, përkundër dëshmimeve që vërtetojnë këto shpenzime; dhe (iii) mosnjohjen e faturave nga ATK për shitblerjet me kompaninë “S”. Më 10 mars 2016, Departamenti i Ankesave i ATK-së përmes Vendimit [455/2015]: (i) aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës si dhe ndryshoi Njoftimin për Rivlerësimet, duke njohur një pjesë të shpenzimeve operative për periudhën 2011 si dhe një pjesë të qarkullimit shtesë lidhur me subjektet “N.B” dhe “G.B”; ndërsa (ii) refuzoi faturat lidhur me transaksionet me kompaninë “S.”, duke i kualifikuar ato si fiktive. Përkitazi me pjesën refuzuese të Vendimit të lartcekur, ATK kishte arsyetuar, ndër të tjera, se: (i) bazuar në paragrafin 7 të nenit 13 (Krijimi dhe mbajtja e regjistrave) të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (në tekstin e mëtejme: LAT) dhe nenit 22 (Transaksionet mbi

Pesëqind Euro) të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi Administrativ nr. 15/2010), subjektet ekonomike janë të detyruara që transaksionet me vlerë më të madhe se pesëqind (500) euro t'i bëjnë përmes llogarive bankare, dëshmi të cilat përkitazi me faturat e kontestuarra parashtruesi i kërkesës nuk i kishte ofruar; dhe (ii) bazuar në paragrafin 6 të nenit 19 (Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm për Tatimin) të Ligjit për Administratën Tatimore, barra për të provuar se vlerësimi tatimor është i gabuar bie mbi tatimpaguesit, përkatësisht parashtruesin e kërkesës, ndërsa ky i fundit nuk kishte dëshmuar se konstatimet e Njoftimit për Rivlerësimet lidhur me faturat për kompaninë "S" ishin të pasakta, për më tepër që *"transaksionet në mes dy subjekteve kanë qenë fiktive, sepse edhe pala ka dhënë deklaratë që nuk kanë kryer asnjë shërbim apo shit-blerje të mallit, por vetëm kanë lëshuar fatura fiktive"*.

15. Më 13 prill 2016, kundër Vendimit të lartcekur të ATK-së, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të anulohet Vendimi [455/2015] i 10 marsit 2016 i Departamentit të Ankesave të ATK-së. Më 13 prill 2018, dhe përderisa çështja e tij ishte ende në pritje në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, për *"kthimin e dokumentacionit të konfiskuar me rastin e bastisjes"*. Sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës dhe shkresave të lëndës, ai asnjëherë nuk ka marrë asnjë përgjigje përkitazi me kërkesën e tij.
16. Më 29 maj 2018, në shqyrtimin e mbajtur në Gjykatën Themelore, bazuar në procesverbalin e kësaj të fundit, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se i ishte pamundësuar të vërtetuarit e transaksioneve, duke përfshirë ato me subjektin "S." Parashtruesi i kërkesës theksoi se (i) *"më datë 10.12.2014 Policia e Kosovës, ka bërë sekuestrimin e gjithë dokumentacionit financiar të paditësit, kompjuterëve, për çka gjykatës ia prezantojmë si provë dëshminë e sekuestrimit nga Policia e Kosovës. Pas sekuestrimit të dokumentacionit ATK, dorëzon draft-raportin e kontrollit ku paditësi nuk mund të paraqet vërejtje konkrete në mungesë të dokumenteve."*; (ii) *"më 26 nëntor 2015, kishte kërkuar nga Prokuroria, ATK-ja dhe Policia që t'i ofroheshin dokumentet financiare"*, por nuk i ishin ofruar; (iii) si pasojë e mungesës së dokumentacionit, *"më shumë vështirësi ka arritur që t'i siguroj disa prova nga subjektet me të cilat kishte bashkëpunuar"*; dhe (iv) si rezultat i pamundësimit të qasjes së tij në këtë dokumentacion, është shkelur neni 9 (Parimi i publicitetit) i Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (në tekstin e mëtejshëm: LPA) dhe të drejtat e tij kushtetuese të garantuara përmes nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës.
17. Më 29 maj 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 548/16] e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke vërtetuar Vendimin [455/2015] e ATK-së. Gjykata Themelore: (i) përkitazi me pretendimet për sekuestrimin dhe për pasojë mungesën e dokumentacionit financiar, theksoi se *"paditësja ka mundur t'i siguroj provat nga banka apo tek subjekti që ka lëshuar faturat kontestuese, se është bërë pagesa e këtyre faturave"*; dhe (ii) përkitazi me faturat kontestuese me kompaninë "S" theksoi se *"paditësja nuk ka arritur t'i vërtetoj pagesat apo deklarin e blerjeve mbi pesëqind (500) euro, sikurse që parashihet në dispozitën e nenit 22 [Transaksionet mbi pesëqind euro] par. 2 të Udhëzimit Administrativ 15/2010"*. Përfundimisht, Gjykata Themelore konstatoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t'u njohur faturat përkatëse bazuar në nenin 23 (Anulimi i Dokumenteve Tatimore) të Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13 (Deaktivizimi i një Biznesi), 14 (Anulimi i Dokumenteve Përfshirë Numrin Fiskal) dhe 16 (Publikimi i Emrave dhe Numrave të Tatimpaguesve) të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010.



18. Më 9 gusht 2018, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Përmes ankesës së tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të të drejtave të tij të garantuara përmes: (i) nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, me theks në faktin se Gjykata Themelore nuk kishte marrë parasysh nenin 9 (Parimi i publicitetit) të LPA-së dhe paragrafin 6 të nenit 14 (Qasja në libra, regjistrime, kompjuterë dhe pajisje të tjera për ruajtjen e regjistrave) të Ligjit për Administratën Tatimore; dhe (ii) nenit 32 të Kushtetutës, me theks në faktin se, si rezultat i mungesës së dokumentacionit financiar, i ishte pamundësuar ushtrimi efektiv i mjetit juridik kundër Njofimit për Rivlerësimet të ATK-së.
19. Më 16 prill 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA. nr. 501/2018], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
20. Më 7 korrik 2019, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndër tjerash, edhe në kontekst të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, lidhur me pretendimet që kishte ngritur para Gjykatës së Apelit për: (i) shkeljen e nenit 9 të LPA-së dhe paragrafit 6 të nenit 14 të Ligjit për Administratën Tatimore; dhe (ii) shkeljen e neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës. Më 1 gusht 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [ARJ.UZVP. nr. 94/2019], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke e konfirmuar këtë të fundit. Gjykata Supreme (i) përkritazi me pretendimet për sekuestrimin dhe për pasojë, mungesën e dokumentacionit financiar, theksoi se *“paditësi ka mundur t'i siguroj provat nga banka apo tek subjekti që ka lëshuar faturat kontestuese se i njëjti i ka paguar këto fatura”*; (ii) përkritazi me faturat kontestuese me kompaninë “S” theksoi se *“paditësi nuk ka arritur t'i vërtetoj pagesat apo deklarimin e blerjeve mbi pesëqind (500) euro, sikurse që parashihet në dispozitën e nenit 22 par. 2 të Udhëzimit Administrativ 15/2010”*; ndërsa (iii) përfundimisht, miratoi konstatimet e gjykatave më të ulëta, se në rrethanat e rastit konkret, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t'u njohur faturat përkatëse bazuar në nenin 23 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010.
21. Më 14 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës e kishte parashtruar kërkesën e parë KI227/19 në Gjykatë, nëpërmjet së cilës kontestoi Aktgjykimin [ARJ.UZVP. nr. 94/2019] e 1 gushtit 2019 të Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij, të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.

## **ii. Përmbledhje e fakteve të kërkesës së tanishme KI225/21**

22. Më 10 dhjetor 2020, Gjykata, përkritazi me kërkesën e sipërcekur nxori Aktgjykim, nëpërmjet të cilit e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr.94/2019] e 1 gushtit 2019, të Gjykatës Supreme, për arsye se i njëjti nuk i përmbushte standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor siç kërkohej me nenin 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNj-së. Në këtë rast, Gjykata kishte kërkuar nga Gjykata Supreme që në riprocedurë t'i evitonte mangësitë procedurale që kishin shkaktuar shkeljen e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për vendim të arsyetuar, duke adresuar dhe arsyetuar

pretendimet përkitazi me barazinë e armëve dhe mjetet efektive juridike. Për më tepër, Gjykata kishte konstatuar se: *“... në nxjerrjen e Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr. 94/2019] të 1 gushtit 2019, Gjykata Supreme ka dështuar të arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me shkeljen e ligjit të aplikueshëm, përkatësisht LPA-së dhe Ligjit për Administratën Tatimore dhe shkeljen e neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës. Përkitazi me këto dy të fundit, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar vazhdimisht se mungesa, përkatësisht pamundësia për të pasur qasje në dokumentacionin e tij financiar, kishte rezultuar në cenimin e barazisë së armëve para gjykatave të rregullta dhe pamundësinë e ushtrimit të mjeteve juridike në mënyrë efektive”*.

23. Më 8 shkurt 2021, Gjykata Supreme, bazuar në Aktgjykimin KI227/19 të 10 dhjetorit 2020, të Gjykatës, nxori Aktgjykimin ARJ.UZVP.nr. 16/2021, nëpërmjet të cilit refuzoi si të pabazuar kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke konkluduar se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë pretendimet e tij në mënyrë të mjaftueshme dhe se barra e provës për të vërtetuar pretendimet e tij i ka takuar vetë parashtruesit të kërkesës sipas ligjit në fuqi.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe Aktgjykimi i dytë [ARJ.UZVP. nr. 16/2021] i 8 shkurtit 2021, i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në kuptim të së drejtës “për një vendim gjyqësor të arsyetuar” sepse nuk janë adresuar dhe arsyetuar pretendimet e tij në lidhje me “barazinë e armëve” dhe “ushtrimin efektiv të mjeteve juridike”, e gjitha si pasojë e mungesës së dokumentacionit financiar të sekuestruar nga autoritetet kompetente.

#### *i. Pretendimet për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor*

25. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi [ARJ.UZVP. nr. 16/2021] i 8 shkurtit 2021 vazhdon të karakterizohet nga mungesa e arsytimit në lidhje me pretendimet e tij thelbësore, sepse Gjykata Supreme nuk ka arritur të japë arsyetim për konstatimet kryesore dhe çështjet e ngritura nga Gjykata Kushtetuese, në rastin KI227/19, përkitazi me konstatimin e Gjykatës Supreme se *“nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t’i pranuar faturat”*, duke u bazuar në nenin 23 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe nenet 13, 14 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, ku Gjykata Kushtetuese kishte theksuar se dispozitat në të cilat Gjykata Supreme ka bazuar konstatimin e saj për refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, nuk ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret.
26. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme, duke konfirmuar aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, ka arsyetuar qëndrimin e saj, duke u bazuar në nenin 22 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, sipas të cilit, *“të gjithë personat, të cilët kryejnë transaksione, gjatë aktivitetit të tyre ekonomik në lidhje me furnizimin e mallrave apo shërbimeve, në mes të personave, më të larta se 500 (pesëqind) euro, pagesa e transaksionit duhet të bëhet nëpërmjet llogarisë bankare”*, duke theksuar rrjedhimisht se të gjitha dëshmitë e nevojshme do të mund të siguroheshin nëpërmjet bankës përkatëse nga parashtruesi i kërkesës.

#### *ii. Pretendimet për shkelje të parimit të “barazisë së armëve” dhe të së drejtës për “mjet efektiv juridik”*

27. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës, thekson se Gjykata Supreme ashtu sikur herën e parë edhe tani nëpërmjet nxjerrjes së Aktgjykimit [ARJ. UZVP. nr. 16/2021], nuk i ka shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet thelbësore lidhur me cenimin e të drejtës për: i) barazi të armëve dhe ii) të drejtës për mjet efektiv juridik, duke e ndërlidhur shkeljen e këtyre të drejtave kushtetuese me mungesën e dokumentacionit financiar, i cili i është sekuestruar nga autoritetet kompetente. Parashtruesi i kërkesës pohon se pretendimi i ngritur para gjykatave të rregullta ka qenë fakt vendimtar që do të ndikonte në nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm, duke i respektuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.
28. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Gjykata Kushtetuese në herën e parë në trajtimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës në rastin e njëjtë [KI227/19], në kontekst të vendimit të arsyetuar gjyqësor kishte theksuar se pretendimet thelbësore, dhe posaçërisht ato që ndërlidhen me shkelje të Kushtetutës dhe KEDNj-së, duhet të arsyetohen pavarësisht relevancës së tyre për vendimmarrjen përkatëse. Heshtja e një gjykatë përkitazi me pretendime të tilla, siç është përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, e pamundëson konstatimin nëse gjykatat përkatëse thjesht kanë neglizhuar të merren me këto pretendime apo kanë nënkuptuar refuzimin e tyre dhe, nëse ky ishte qëllimi, cilat ishin arsyet e saj për një qasje të tillë”.*
29. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se, që nga fillimi i procesit gjyqësor palët asnjëherë nuk kanë qenë të barabarta, duke e cenuar rëndë, kështu, edhe parimin kushtetues të barazisë para ligjit të përcaktuar nga neni 24 i Kushtetutës.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi [ARJ. UZVP. nr. 16/2021] i Gjykatës Supreme nuk është në përputhshmëri me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, për shkak se i lartcekuri vazhdon të karakterizohet nga mungesa e arsyetimit në lidhje me pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë edhe ato që janë kërkuar në mënyrë shprehimore me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI227/19. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se e tërë procedura që nga fillimi, duke filluar nga ATK-ja, është zhvilluar në mungesë të dokumentacionit financiar të tij, duke ia cenuar të drejtën kushtetuese të përcaktuar me nenin 32 të Kushtetutës, për barazi të armëve në procedurë dhe ushtrim efektiv të mjeteve juridike në dispozicion.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

#### **Neni 32**

#### **[E Drejta për Mjete Juridike]**

*“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.*

## **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

### **Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.  
[...]

### **Neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive)**

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

## **Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative**

### **Neni 9 (Parimi i publicitetit)**

- 9.1. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.
- 9.2. Çdo person fizik dhe juridik, pa qenë e nevojshme të tregojë interes specifik, në raportet me organet e administratës publike, ka të drejtat procedurale që vijnë:  
a) të marrë informacion që është në zotërim të një organi të administratës publike,  
b) brenda një kohe të arsyeshme,  
c) në të njëjtën mënyrë si për çdo person tjetër,  
d) me mjete të përshtatshme dhe efektive.
- 9.3. Përgjithësisht nga paragrafi 2, informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me ligje përkatëse.
- 9.4. Për refuzimin e qasjes në informacion, organi i administratës publike merr vendim me shkrim, i cili vendim duhet të përmbajë arsyet e vendimit dhe udhëzimet për ankesë.

## **Ligji 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat**

### **Neni 13 (Krijimi dhe mbajtja e regjistrave)**

- [...]
7. Çdo transaksion mbi pesëqind (500) euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, pas 1 janarit të vitit 2009 kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare.

[...]

**Neni 14**  
**(Qasja në libra, regjistrime, kompjuterë dhe pajisje të tjera për ruajtjen e regjistrave)**

[...]

6. Duke iu nënshtruar të drejtës për të mbajtur një dokument si provë për veprë penale, Drejtori i Përgjithshëm ose zyrtari i autorizuar i cili merr dhe mban regjistrat sipas këtij neni do të bëjë një kopje të regjistrit dhe do të kthejë origjinalin në kohën më të shkurtër nga ana praktike.

[...]

**Neni 19**  
**(Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm për Tatimin)**

[...]

6. Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë.

[...]"

**Udhëzimi Administrativ Nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat**

**Neni 22**  
**(Transaksionet mbi pesëqind euro)**

1. Paragrafi 7 i Nenit 13 të Ligjit, përcakton se të gjithë personat, të cilët kryejnë transaksione, gjatë aktivitetit të tyre ekonomik në lidhje me furnizimin e mallrave apo shërbimeve, në mes të personave, më të larta se 500 (pesëqind) euro pagesa e transaksionit duhet të bëhet përmes llogarisë bankare.

2. Për transaksionet e bëra nga 1 janari i vitit 2009 deri më 17 gusht 2010, paragrafi 1 i këtij Neni do të aplikohet nga personat e tatueshëm që nënkupton personat që kërkohet të regjistrohen apo janë të regjistruar për TVSH. Kurse për transaksionet e bëra me datën 18 gusht 2010 apo pas asaj date, paragrafi 1 i këtij Neni do të aplikohet nga të gjithë personat.

**Pranueshmëria e kërkesës**

31. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[...]

33. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:



*“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

34. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individu mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ. UZVP. nr. 16/2021] e 8 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
36. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39  
[Kriteret e pranueshmërisë]

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

37. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii)

pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës*, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmache kundër Francës*, nr. 17621/91, kategoria (i), *Juta Mentzen kundër Lituanisë*, nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, kategoria (iii)).

38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës duke kontestuar Aktgjykimin e 8 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme, sërish ngrenë pretendime që ndërlidhen me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në kuptim të së drejtës për një vendim gjyqësor të arsyetuar, duke e ndërlidhur këtë pretendim me dy pretendime të tjera, atë të cenimit të “barazisë së armëve” dhe të ushtrimit efektiv të mjeteve juridike, të cilat pretendon se kanë ndodhur për shkak të pamundësisë së vërtetimit të transaksioneve të kryera, për mungesë të dokumentacionit financiar që ishte sekuestruar nga autoritetet kompetente për qëllime hetimore.
39. Nga ky përkufizim i mësipërm, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet sërish me të drejtën për një “vendim të arsyetuar gjyqësor”, të cilën e garanton neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së. Andaj në këtë kontekst, Gjykata do e shqyrtojë të njëjtin, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
40. Rrjedhimisht, Gjykata do të analizojë këtë pretendim themelor, duke rikujtuar parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim gjyqësor të arsyetuar, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së dhe të Gjykatës dhe më pas do t’i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

***i. Pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtës për “vendim të arsyetuar gjyqësor”***

***a) Parimet e përgjithshme***

41. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, nr. 12945/87 Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët*



*kundër Francës*, nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, dhe [KI24/17](#), parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019; [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135; dhe së fundmi [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jobankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 120).

42. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6.1 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GjEDNj-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139; dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
43. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që duhet të adresohen, dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme, rastet e GjEDNj-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91 Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 134/1996/753/952. Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin e GjEDNj-së *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përmendura aty; shih edhe rastet e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137; dhe së fundmi [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 122).
44. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës nr. [KI72/12](#), *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61;



[KI135/14](#), *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; [KI87/18](#), parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138; dhe së fundmi rastin [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jobankar "Monego", Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 123).

*b) Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*

45. Gjykata rikujton se në rrethanat e rastit konkret është e rëndësishme të vlerësohet nëse Gjykata Supreme, bazuar në rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese të dhëna në Aktgjykimin e 10 dhjetorit 2020, rasti [KI227/19](#), në riprocedurë ka përmbushur standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, duke i adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të cilat i kishte ngritur nëpërmjet kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, në lidhje me "barazinë e armëve" dhe "mjetet efektive juridike".
46. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme është nxjerrë në përputhshmëri me standardin e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, Gjykata iu referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, e cila fillimisht arsyetoi: *"Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë të paditësit NT "Spahia Petrol" dhe vërejtjeve të paraqitura në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr. [KI227/19](#), Gjykata Supreme pas ekzaminimit të aktgjykimit të goditur, shqyrtimit të pretendimeve nga kërkesa e paditësit dhe vërejtjeve të paraqitura në aktgjykimin e cekur të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit në tërësi e ka pranuar edhe kjo gjykatë, meqë aktgjykimi i goditur nuk është marrë me shkelje në të cilat paditësi thirret në kërkesën e tij"*.
47. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës që kanë të bëjnë me ngarkime financiare shtesë nga ATK-ja, Gjykata Supreme arsyetoi: *"... gjykata e shkallës së parë bazuar në provat, në shkresat e lëndës ka vërtetuar se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin e goditur pjesërisht ka aprovuar ankesën e paditësit dhe pjesërisht e ka ndryshuar vendimin për Lajmërimin/vlerësimin lidhur me pagesën e tatimit shtesë në Tatimin në të ardhurat personale, për periudhën 2011, 2012, 2013 dhe tatimit TVSh për periudhën 06/2012 dhe 03/2013, me të cilat paditësi është obliguar, e që ka të bëjë me rritje KMSH dhe TVSH (12/2011) dhe TAP- për vitin 2011, si dhe refuzimit që të pranojë faturat nga subjekti afarist NTP 'S'. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar se në raportin e kontrollit janë dhënë mjaft arsye konkrete që vërtetojnë rritjen e shitjes për periudhën 2011, si pasojë e diferencës materiale dhe faktit se në librat tregtare dhe në fletëdërgesat ka pasur mallë të padeklaruar. Edhe pas përpjekjeve të kontrollit që të vihet në kontakt me subjektin afarist 'S', nuk ka ardhur deri tek kontakti, meqë i njëjti është vendosur në listën e atyre subjekteve me tendenca të kryerjes së transaksioneve të dyshimta"*.
48. Gjykata tutje vëren se përkitazi me pretendimin për shkelje të dispozitave të Ligjit të procedurës administrative dhe Ligjit për administratë tatimore dhe procedurat, që flasin për kthimin e dokumentacionit financiar, në afat sa më të arsyeshëm nga zyrtari përgjegjës, e që ky pretendim pastaj ndërlihet me shkeljen e parimit të "barazisë së armëve" dhe të "ushtrimin efektiv të mjeteve juridike", Gjykata Supreme, arsyetoi: *"Sa i përket kontestit rreth faturave që nuk janë pranuar ndërsa kanë të bëjnë, me transaksionet me NTP 'S', administrata tatimore ka vendosur duke u bazuar në faktin se paditësi ka qenë i obliguar që të vërtetojë në një mënyrë tjetër të përcaktuar me ligj, siç janë pagesat për mallin mbi 500 euro, e cila është e paraparë me nenin 22,*



paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010. Për më tepër, në këtë kontekst, Gjykata Supreme arsyetoi se “Paditësi gjithashtu ka mundur që pavarësisht nga kontrolli i kryer nga ana e organeve kompetente të hetimit, si dhe të konfiskimit të dokumentacionit financiar, të siguroj provat përmes bankës apo përmes subjektit afarist i cili ka faturuar mallin si të paguar. Në të njëjtën kohë, paditësi nuk ka arritur të dëshmoj dhe të siguroj fletëpagesat, për mallin e padeklaruar nga subjektet që i kanë nënshkruar ato, dhe sipas të cilave ka realizuar qarkullimin”.

49. Gjykata në lidhje me këtë vëren se, Gjykata Supreme, duke adresuar këto pretendime, ka konstatuar përfundimisht se mungesa e dokumentacionit financiar, megjithatë nuk ishte fakt vendimtar dhe me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, sepse bazuar në nenin 13 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenin 22 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, parashtruesi i kërkesës ligjërisht ka qenë i obliguar që çdo transaksion mbi vlerën prej 500 euro, ta bëjë nëpërmjet bankave ose nëpërmjet subjektit afarist i cili ka faturuar mallin, si të paguar. (shih lidhur me ngritjen e argumentit vendimtar për rezultatin e çështjes, rastin e GjEDNj-se, [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 30, si dhe rastin e Gjykatës, [KI195/20](#), parashtrues [Aigars Kesengfelds](#), pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”, Aktgjykimi i 29 marsit 2021, paragrafi 135, ku theksohet se pretendimi i parashtruesit të kërkesës që i referohej aplikimit të gabuar të ligjit, i cili ishte ngritur në Gjykatën Supreme, “nuk ishte përcaktues dhe vendimtar për rezultatin e kërkesës së tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor).
50. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme i ka rikujtuar parashtruesit të kërkesës obligimet ligjore sipas ligjit të aplikueshëm rreth barrës së provës, duke arsyetuar se: “Paditësi nuk ka mundur të dëshmojë se cilat prej blerjeve nuk është e përfshirë në KMSH dhe nëse, ato kanë të bëjnë me shpenzimet operationale apo investimet, kështu që ngarkesa e të provuarit ka rënë tek ai, në pajtim me nenin 19 paragrafi 6 i Ligjit për administratën tatimore dhe procedurën nr. 03/L-222. Provat e mbledhura gjatë kontrollit tatimor e vërtetojnë faktin se në mes të këtyre dy subjekteve ka pasur transaksione fiktive. Sipas fakteve në shkresat e lëndës dhe sipas mendimit të kësaj gjykate, e paditura në mënyrë të pakontestuar ka vërtetuar se qarkullimi i paraqitur i mallit ka rezultuar bazuar në fletëdërgesat e padeklaruar dhe të nënshkruara nga të dyja anët. Tutje, e paditura ka vërtetuar drejtë se faturat e deklaruar nuk i përgjigjen fletëdërgesës së paraqitur është në kundërshtim me Ligjin për administratën tatimore dhe procedurën nr. 03/L-222”.
51. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme arsyetoi se barra e të provuarit në rrethanat e rastit konkret i ka takuar parashtruesit të kërkesës, si palë paditëse, për t’i ofruar gjykatës dëshmi të prekshme dhe të pakontestuar lidhur me transaksionet e ligjshme, duke ia rikujtuar kësaj nenin 19 të Ligjit për administratë tatimore dhe procedurat, gjegjësisht paragrafin 6, që parasheh: “Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë”.
52. Përveç kësaj, Gjykata Supreme ka konsideruar që parashtruesi i kërkesës ka pasur dy mundësi për të provuar të kundërtën e pretendimeve të ATK-së, dhe atë duke ofruar prova në lidhje me: i) kryerjen e pagesave (transaksioneve) nëpërmjet bankës; dhe ii) kryerjen e pagesave nëpërmjet dëshmive të siguruara nga subjekti që ka faturuar mallin, si të paguar. Prandaj, Gjykata është e mendimit se pretendimi i parashtruesit të kërkesës, se e kishte të pamundur për të dëshmuar të kundërtën e pretendimeve të ATK-së për ngarkim shtesë financiar nga kjo e fundit, u vlerësua se nuk ishte vendimtar dhe me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje.



53. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme në mënyrë të nënkuptuar dhe në substancë i ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor, në lidhje me ligjin e aplikueshëm, shkeljen e parimit të barazisë së armëve, dhe ushtrimin e mjeteve juridike në mënyrë efektive. Gjykata rikujton, se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GjEDNj-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], nr. 40490/98, Vendimi i 29 gushtit 2000, paragrafi 81).
54. Tutje, Gjykata përsërit se dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNj-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe të njëjtat dispozita as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI118/17](#), parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2018, paragrafi 36; [KI49/19](#), parashtrues, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 54; dhe [KI99/19](#), parashtruese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48; dhe së fundmi rastin [KI68/21](#), parashtrues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 8 shtatorit 2021, paragrafi 51).
55. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese; dhe [KI22/19](#), parashtrues i kërkesës *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
56. Marrë parasysh parimet e lartcekura, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës këtë radhë janë respektuar kriteret e lartcekura nga Gjykata Supreme, andaj dhe konkluzionet e saj duket të jenë në pajtueshmëri me standardet e kërkuara nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së. Parashtruesi i kërkesës edhe më tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tij, megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GjEDNj-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02 Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
57. Thënë këtë, Gjykata konstaton se vërejtjet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin e 10 dhjetorit 2020 (rasti [KI227/19](#)), janë marrë parasysh nga Gjykata Supreme, sepse e njëjta sqaron dhe arsyeton se cilat kanë qenë detyrimet e parashtruesit të kërkesës, sipas ligjit të aplikueshëm, për të provuar të kundërtën e pretendimeve të ATK-së; se përse nuk ishte me ndikim pretendimi për mungesë të dokumentacionit financiar, për të provuar kryerjen e transaksioneve, duke arsyetuar se megjithatë



parashtruesi i kërkesës kishte në dispozicion të tij edhe mundësi të tjera për të vërtetuar transaksionet e bëra, andaj kësajohet konsumuar edhe pretendimi për shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe të mjetit efektiv juridik, të garantuara me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës, i cili ndërlidhet me mungesën e dokumentacionit financiar dhe nuk është e nevojshme që këto dy pretendime të trajtohen veçmas nga Gjykata.

58. Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar [ARJ.UZVP. nr. 16/2021] i 8 shkurtit 2021, i Gjykatës Supreme, i përmbush standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, meqë i njëjti përmban lidhje logjike, ndërmjet bazës juridike të aplikuar, arsytimit dhe përfundimeve të nxjerra. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në kuptim të së drejtës për një vendim gjyqësor të arsyetuar, të ndërlidhura me parimin e barazisë së armëve dhe ushtrimin efektiv të mjetit juridik, i përkasin kategorisë së dytë (ii), pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* andaj, si të tilla të njëjtat, në baza kushtetuese i shpallë qartazi të pabazuara.

## **ii. Përkitazi me pretendimet e tjera**

59. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë pretendon dhe në shkelje të nenit 24 të Kushtetutës. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës shkeljen e kësaj të drejte e ndërlidhë me nenin 31 të Kushtetutës, barazia e armëve, për të cilën Gjykata sa më lart konstatoi se kërkesa në këtë pjesë duhet deklaruar qartazi e pabazuar në baza kushtetuese. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të neneve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNj-së, nëse më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
60. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i përket kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve *“të pambështetura ose të paarsyetuara”*, andaj, si të tillë, në baza kushtetuese edhe këtë pretendim duhet shpallur qartazi të pabazuar.

## **Përfundim**

61. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në kuptim të së drejtës për një vendim gjyqësor të arsyetuar, të ndërlidhura me parimin e barazisë së armëve dhe ushtrimin efektiv të mjetit juridik, i përkasin kategorisë së dytë (ii), pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* andaj, si të tilla të njëjtat, në baza kushtetuese i shpallë qartazi të pabazuara; (ii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i përket kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve *“të*

*pambështetura ose të paarsyetuara*", andaj, si të tillë, në baza kushtetuese edhe këtë pretendim e shpallë qartazi të pabazuar.

62. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, duhet deklaruar qartazi e pabazuar dhe e papranueshme.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4, 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, me rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 shtator 2022, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani